VENDIM
Nr.45, datë 15.7.2010

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E FAKTEVE, RRETHANAVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË MASAKRËS SË TIVARIT, 1945

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891 datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore", si dhe të neneve 25 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet komisioni hetimor i Kuvendit për hetimin e fakteve, rrethanave dhe përgjegjësive të masakrës së Tivarit të vitit 1945.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

a) hetimi për zbardhjen e plotë të ngjarjeve dhe përgjegjësive të individëve, ideatorëve, ekzekutuesve, ndihmësve dhe bashkëpunuesve për masakrën e Tivarit, të ndodhur në fund marsi - fillim prilli të vitit 1945;

b) hetimi i plotë i ngjarjeve që paraprinë masakrën e Tivarit dhe roli i individëve të përfshirë në secilën prej tyre;

c) zbardhja e plotë e së vërtetës historike për masakrën e Tivarit të vitit 1945 dhe nxjerrja e përgjegjësive shtetërore dhe individuale e personave që me veprimet apo mosveprimet e tyre kontribuan, lejuan dhe ndihmuan në kryerjen e saj;

ç) hetimi i plotë i fakteve dhe dokumentacionit të qëndrimit të shtetit shqiptar në vitet 1945-1990 në lidhje me këtë masakër, i përpjekjeve për zbardhjen dhe/ose fshehjen e së vërtetës për të dhe roli i strukturave shtetërore dhe individëve të kohës në raport me të.

III. Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 13 deputetë. Kryetari i përket Partisë Demokratike. Përbërja e komisionit është si më poshtë:

1.	Fatos Beja	Kryetar	(PD)
2.	_____	Zëvendëskryetar	(PS)
3.	Mesila Doda	Anëtare	(PD)
4.	Viktor Gumi	Anëtar	(PD)
5.	Gent Strazimiri	Anëtar	(PD)
6.	Fatos Hoxha	Anëtar	(PD)
7.	Adriana Gjonaj	Anëtare	(PD)
8.	Gjergji Papa	Anëtar	(PD)
9.	_____	Anëtar	(PS)
10.	_____	Anëtar	(PS)
11.	_____	Anëtar	(PS)
12.	_____	Anëtar	(PS)
13.	_____	Anëtar	(PS)

IV. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 12-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

V. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij komisioni.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)